



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Delivered	24.02.2023	viti god Year	3
Organ /Njësia Organ /Jednitsa Org./Unit	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kohësia Quantity	
SKPM/SHK	2037/2023	1/5	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.62/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, si dhe Vjollca Sinani-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.62/2023 të datës 13.01.2023, të parashtruar nga ankuesja _____, kundër organit të punësimit, Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 23.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.62/2023, e datës 13.01.2023 e parashtruar nga ankuesja _____
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. 01/XII/2022 i datës 13.12.2022 i Komisionit të Vlerësimit për Ngritje ne Detyre i Ministrisë së Shëndetësisë.

A r s y e t i m

Ministria e Shëndetësisë me datë 21.09.2022 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me numër referencës RN00009924 për ngritje (avancim) në detyrë për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrjen dhe Zbatimin e Legjislacionit, ku afati për aplikimin ka qenë nga data 06.10.2022 deri më datë 14.10.2022. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila i është nënshtruar fazave të procedurës.

Bazuar në rendjen përfundimtare të kandidatëve të datës 25.11.2022, ankuesja është vlerësuar me gjithsej 66.84, respektivisht në testin me shkrim është vlerësuar me 43 pikë, në vlerësimin e jetëshkrimit me 17.67 pikë ndërsa në intervistë me gojë është vlerësuar me 6.17 pikë dhe është renditur e dyta me pikë, ndërsa ankuesja më datë 29.11.2022 është njoftuar përmes emailit nga SIMBNJ për publikimin e rezultateve të vlerësimit.

Ankuesja më datë 06.12.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Vlerësimit për Ngritje në Detyrë, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit me Nr. 01/XII/2022 të datës 13.12.2022 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja kundër këtij vendimi me datën 12.01.2023 ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar më datë 13.01.2023 me numër të protokollit 253/2023 me pretendimet ankimore për shkelje thelbësore të dispozitave ligjore, shkelje procedurale dhe vlerësim të gabuar, jo real dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave me datë 25.01.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Shëndetësisë , ndërsa kjo e fundit më datë 13.02.2023 ka përcjell në Këshill provat lidhur me çështjen në shqyrtim dhe vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e vendimmarrjes sa i përket kësaj ankese ka administruar këto prova; Ankesën me numër të protokollit 253/2023 të datës 13.01.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Email nga SIMBNJ e datës 29.11.2022; Email nga SIMBNJ e datës 06.12.2022; Email nga ankuesja e datës 06.12.2022; Email i datës 13.12.2022; Publikimi i rezultateve me datë 29.11.2022; Publikimi i rezultateve me datë 06.12.2022; Ndryshimi i publikimit me datë 08.12.2022; Vendimi i datës 13.12.2022 nga Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrë; Përgjigjeje në kërkesë e datës 03.02.2023 nga Ministria e Shëndetësisë, Kërkesë për rekrutim e datës 06.07.2022; Konkursi i datës 21.09.2022 me numër RN00009924; Aplikacioni i ankueses; Akt emërimi i ankueses e datës 07.12.2011; Lista e aplikantëve; Renditja përfundimtare e aplikantëve; Vendim i datës 27.10.2022; Dokumente shtesë e datës 13.02.2023; Vendimi i datës 15.11.2019; Vendim i datës 18.08.2021; Aplikacioni i K.Sh; Certifikatë e trajnimit e K.Sh 26-29 janar 2010; Certifikatë e K.Sh 28-29 prill 2009; Vendim me Nr.56/2023 e datës 07.02.2023; Certifikatë e trajnimit e K.Sh 20-23 dhjetor 2005; Certifikatë e trajnimit e K.Sh nga FLSA; Certifikatë e trajnimit e K.Sh nga B&S Europe dhe IKAP; Akt emërimi i K.Sh. me nr.047 i datës 10.02.2012; Vendimi i datës 15.03.2019 për K.K; Letërnjoftimi i K.K; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për K.Sh. për vitin 2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për K.Sh. për vitin 2019; Vërtetim i marrëdhënies së punës për K.Sh. e datës 11.10.2022; Certifikatë për K.Sh. nga Fakulteti Juridik për vërtetimin e dhënies se te gjitha provimeve e datës 11.11.2002, Prishtinë; Aplikacioni i B.B; Diplomë e B.B, Jurist i Diplomuar; Certifikatë për B.B nga IKAP; Certifikatë për B.B nga House of Training; Certifikatë për B.B nga IKT; Certifikatë për B.B nga AUK; Certifikatë për B.B nga IKAP e datës 20-21 prill 2015; Certifikatë për B.B nga LSE; Certifikatë për B.B nga OSCE dhe Oda e Avokatëve të Kosovës; Certifikatë për B.B nga IKAP dhjetor 2012; Certifikatë për B.B nga IKAP me nr.240/2018; Certifikatë për B.B nga FondaKOS e datës 05.08.2004; Certifikatë për B.B nga IFES; Certifikatë për B.B nga UNMIK; Certifikatë për B.B nga EIPA; Vërtetim për B.B nga Qendra Korrektuese Lipjan; Vërtetim për B.B

nga BSHE "AFARISTI" Vërtetim për B.B nga Sekretariati i komisionit qendror të zgjedhjeve; Flet rekomandim për B.B nga zyra e regjistrimit të popullit; Akt emërim i datës 07.12.2011; Vendim nga Kuvendi me nr.ZK-60/12 i datës 12.11.2012; Vendim për B.B nga Agjencia për Ndhimë Juridike Falas; Vendim për B.B i datës 21.04.2020 me nr.23/2020; Vendim për B.B i datës 10.07.2020 me nr.53/2020; Referenc për B.B nga IFES Kosovo; Letërnjoftimi i B.B; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për B.B. për vitin 2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për B.B. për vitin 2019; Dëshmi për masë disiplinore e datës 25.02.2022 nga MFPT për B.B; Referencë për B.B nga MF për B.B; Letër Reference nga MF për B.B; Vërtetim për periudhën e punës nga MFPT nga B.B; Certifikatë e Hetimeve për B.B nga Gjykata Themelore; Vendim për B.B nga Agjencia për Ndhimë Juridike Falas e datës 29.09.2014; Vërtetim për B.B nga BSHE "AFARISTI" me nr.03/01.dt.18.10.2013; Shkresë/Email nga B.B e datës 23.maj.2016 nga O.D; Shkresë/Email nga B.B e datës 30.maj.2016 nga O.D; Diplomë e B.B, MA.SC.I Shkencave Juridike-Penale; Certifikatë për B.B nga IKAP, maj 2021; Certifikatë për B.B nga Oda e Avokatëve të Kosovës e datës 17 janar 2016; Certifikatë për B.B nga IKAP mars 2016; Certifikatë për B.B nga LSE e datës 18.01-27.05.2002; ; Certifikatë për B.B nga LSE e datës 10.10-14.01.2002; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për B.B. për vitin 2021; Aplikacioni i A.M; Diplomë e B.B, Jurist i Diplomuar - Bachelor; Certifikatë për A.M nga Ministria e Drejtësisë; Letërnjoftimi i F.Z; Certifikatë për A.M nga IKAP, Nëntor 2018; Certifikatë për A.M nga MAP; Mirënjohje nga MPB për A.M; Certifikatë për A.M nga MAP, Qershor 2018; Vërtetim nga EMONA Sh.P.K për A.M; Vendim për pëlqim sanitar me nr.868/1 e datës 25.01.2023; Vërtetim me nr.218/2018 e datës 05.02.2018 për A.M; ARBK Certifikatë e regjistrimit; Akt Emërimi i A.M i datës 01.06.2018; Letërnjoftimi i A.M; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për A.M. për vitin 2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për A.M. për vitin 2020; Vërtetim për marrëdhënien e punës për A.M nga MD; Certifikatë e Shtetësisë për A.M; Certifikatë e Hetimeve për A.M nga Gjykata Themelore; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për A.M. për vitin 2022; Diplomë e Masterit për A.M; Forma individuale për Intervistë i anëtarit S.O; Forma individuale për Intervistë i anëtarit H.S; Forma individuale për Intervistë i anëtarit U.B; Ankesë nga B.B për komisionin në Ministrin e Shëndetësisë; Lista e ngushtë e kandidateve nga NBNJ në MD.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pa bazuar, sepse:*

Në bazë të konkursit me numër referencës RN00009924 për ngritje (avancim) në detyrë për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrjen dhe Zbatimin e Legjislacionit, kriteret e përcaktuar kanë qenë: *"Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare në Fakultetin Juridike me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. Përvoja e punës e kërkuar: Së paku pesë (5) vite përvojë punë profesionale".*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 01/XII/2022 të datës 13.12.2022 të Komisionit të Vlerësimit për Ngritje ne Detyrë i Ministrisë së Shëndetësisë, pretendon se në këtë procedurë ka pasur shkelje procedurale për faktin se publikimi i rezultatit final është bërë ende pa kaluar afati për ankesë prej 7 ditëve; Vendimmarrja e këtij komisioni është në kundërshtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative sepse i njëjti organ po vendos për procedurën e rekrutimit dhe i njëjti për e shqyrton ankesën dhe po nxjerr vlerësimin vet; po ashtu pretendon se janë shkelur parimet e përcaktuara me nenin 6 të Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së procesit për ngritje (avancim) në detyrë për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrjen dhe Zbatimin e Legjislacionit, ka konstatuar se sipas Vendimit me Nr.431/X/2022 të datës 27.10.2022 është emëruar Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrë në përbërje prej tre anëtarëve siç parashihet më dispozitat e nenit 39 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“5. Vlerësimi i kandidatëve bëhet nga një komision vlerësimi ad hoc i themeluar nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit, me këtë përbërje: 5.1. një përfaqësues i Njesisë përgjegjëse; 5.2. dy (2) përfaqësues të institucionit, njëri nga të cilët nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese nga institucioni apo nga një institucion tjetër i Shërbimit Civil me përgatitje të veçantë në procesin e përzgjedhjes dhe tjetri nëpunës i specializuar i Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit që ka vendin e lirë”* dhe nenin 59 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se në këtë procedurë ka pasur shkelje procedurale për faktin se publikimi i rezultatit final është bërë ende pa kaluar afati për ankesë prej 7 ditëve, Kolegji i Këshillit, konstaton se në bazë të provave të lëndës më datë 25.11.2022 është bërë vlerësimi i rezultateve përfundimtare ku ankuesja është vlerësuar me gjithsej 66.84, respektivisht në testin me shkrim është vlerësuar me 43 pikë, në vlerësimin e jetëshkrimit me 17.67 pikë ndërsa në intervistë me gojë është vlerësuar me 6.17 pikë dhe është renditur e dyta me pikë, ndërsa kandidatja K.Sh është vlerësuar me 80 pikë, me 51 në testin me shkrim, me 19.33 në vlerësim të jetëshkrimit dhe me 9.67 në intervistë me gojë, ndërsa ankuesja në mënyrë individuale më datë 29.11.2022 është njoftuar për rezultatin përfundimtar. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, në kuptim të vlerësimit dhe njoftimit për ankuesen është vepruar në pajtim me nenin 49 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse lista përfundimtare e kandidatëve është bërë në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni ndërsa njoftimi për ankuesen për rezultatin përfundimtar është bërë në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, ndërsa nga provat e dërguar si nga ankuesja po ashtu edhe nga organi i punësimit respektivisht Ministria e Shëndetësisë nuk ka njoftim për kandidatin fitues sepse i njëjti nuk është publikuar pa u shqyrtuar të gjitha ankesat eventuale në këtë procedurë, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se ky pretendim i ankueses është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankueses e cila pretendon se Vendimi me Nr. 01/XII/2022 i datës 13.12.2022 i Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë i Ministrisë së Shëndetësisë është i kundërligjshëm sepse i njëjti organ po vendos për procedurën e rekrutimit, i njëjti po shqyrton ankesën dhe po ashtu po jep vlerësimin përfundimtar për kandidatët në këtë procedurë avancimi, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas nenit 63 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *“Dispozitat e neneve 48 deri 51 zbatohen përshtatshëm për procedurën e ngritjes në detyrë”*, ndërsa ligjdhënësi përmes dispozitave ligjore në fuqi i dha dhënë kompetencë Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë që të zhvillojë procedurën po në të njëjtën kohë i ka dhënë kompetencë të bëjë edhe shqyrtimin e ankesës ndaj rezultateve të fazës së vlerësimit siç parashihet me nenin 50 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“1.Kundër rezultatit të fazës të vlerësimit, çdo kandidat i interesuar, mund të paraqesë ankesë të brendshme, brenda shtatë (7) ditëve nga data e njoftimit individual. 2.Ankesa shqyrtohet nga KVLBK, dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj”*, kështu që pretendimet e ankueses janë të

pabazuara, sepse Vendimi me Nr. 01/XII/2022 i datës 13.12.2022 i Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë të Ministrisë së Shëndetësisë përveç që është nxjerr në pajtim me kompetencën e përcaktuar sipas dispozitave të lartcekura, i njëjti është në pajtim edhe me frymën e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit në bazë të administrimit të provave materiale, vlerëson se edhe ankuesja po ashtu edhe kandidatja K.Sh, kanë plotësuar kushtet e përcaktuar në konkursin e shpallur dhe kushtet për aplikim të cilat kërkohen sipas nenit 52 dhe 53 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit, meqenëse nuk ka evidentuar ndonjë shkelje procedurale në këtë procedurë, atëherë në kuptim të dispozitave ligjore në fuqi për zyrtarët publikë, kjo procedurë konsiderohet e ligjshme, rrjedhimisht sa i përket kësaj procedure është vepruar në pajtim me parimet e përcaktuar me nenin 6, nenin 39 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës lidhur me procedurën e ngritjes (avancimit) në detyrë, kështu që të gjitha pretendimet e ankueses janë të pabazuara.

Theksuar i më lart, e duke bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.62/2023, datë 23/02/2023.

Vjollca SINANI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.